

VENDIM
Nr.526, datë 22.8.2007

**PËR FUNKSIONIMIN E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR ÇËSHTJET ME
ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT (NATO)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e funksionit të Koordinatorit Kombëtar për Çështjet me NATO-n, për bashkërendimin ndërinstitucional në marrëdhëniet me NATO-n dhe të veprimtarive të anëtarësimit në këtë organizatë.

2. Koordinatori Kombëtar bashkërendon veprimtaritë e Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe institucioneve qendrore, me strukturat përgjegjëse të zyrës së Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe institucionet e pavarura, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar me NATO-n.

3. Koordinatori Kombëtar organizon, bashkërendon dhe ndjek zbatimin e detyrave, të ministrive dhe institucioneve qendrore. Që rrjedhin nga angazhimet për anëtarësimin në NATO.

4. Koordinatori Kombëtar kryeson grupin ndërmnistror të punës, që krijohet me urdhër të Kryeministrit, në nivel zëvendësministrash, për hartimin dhe monitorimin e planit të veprimit, për anëtarësim në NATO.

5. Për përmbushjen e funksionit, Koordinatori Kombëtar ka këto detyra dhe të drejta:

a) Me porosi dhe/ose me dënim të Kryeministrit ose në bazë të detyrave të MAP-it, komunikon dhe shkëmben të dhëna me zyrën e Presidentit të Republikës, Kuvendin dhe institucionet e tjera, të pavarura.

b) Komunikon drejtpërdrejt me ministrat dhe titullarët e institucioneve qendrore, për t’u përcjellë porositë e Kryeministrit, për marrjen e të dhënave dhe për çështjet, që mund të dalin gjatë ndjekjes së zbatimit të detyrave, në kuadër të procesit të integritetit në NATO etj.

c) Vë në dënim Kryeministrin dhe merr porosi prej tij, në çdo rast, për kontaktet me strukturat e NATO-s.

ç) Vë në dënim, periodikisht, Kryeministrin, për rezultatet e kontakteve me strukturat e NATO-s, si dhe jep vlerësim e mendim, për ecurinë e realizimit të detyrave, nga institucionet shtetërore, në kuadër të procesit të anëtarësimit në NATO.

d) Pajiset me vulë zyrtare të veçantë për dokumentet shkresore, të nënshkruara prej tij.

dh) Inventarizon dhe tërheq të gjithë dokumentacionin shkresor për/nga NATO-ja, të administruar nga institucionet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 5, si dhe kërkon informacion nga institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi. Dokumentacioni ruhet dhe qarkullon nëpërmjet protokollit të Kryeministrit.

6. Koordinatori Kombëtar e ushtron veprimtarinë pranë Këshillit të Ministrave. Për përmbushjen e detyrave, koordinatori kombëtar ndihmohet nga koordinatorët dhe asistenti, të cilët organizohen si njësi e veçantë, në përbërje të Kryeministrit. Njësia do të funksionojë deri në shkrirjen e funksionit të Koordinatorit Kombëtar, me anëtarësimin e vendit tonë në NATO.

Marrëdhëniet e koordinatorëve dhe të asistentit rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

7. Koordinatori Kombëtar, koordinatorët dhe asistenti emërohen dhe lirohen nga detyra me urdhër të Kryeministrit.

8. Koordinatori Kombëtar njësohet në pagë dhe në trajtimet e tjera me funksionin e drejtorit të kabinetit të Kryeministrit dhe, në nivel protokollar, me funksionin e zëvendësministrit, ndërsa koordinatorët dhe asistenti njësohen në pagë, përkatësisht, me funksionin drejtor në ministri, (II-b)” dhe “Specialist, (IV-a)”.

Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet

e përmendura në këtë vendim, për zbatimin e tij.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha